



Data: 12 mars 2018

Buletin Informativ


Nr.1, 2018

Botuar nga:

Zyra e Marrëdhënieve me Publikun dhe Teknologjisë së Informacionit D.V.P. Elbasan

Botim periodik i DVP Elbasan

Intervistë me Drejtorin e D.V.P. Elbasan



Pyetje: Që nga 15 Shkurti ju jeni zyrtarisht Drejtori Policisë Vendore Elbasan. Cilat janë objektivat afatgjat dhe afatshkurtër që ju synoni të realizoni?

Përgjigje: Ne kemi disa objektiva puna. Në plan afatgjatë mund të përmendim:

- Krijimi i një ambienti sa më të sigurt për të gjithë qytetarët qarkut të Elbasanit;
- Rritja e cilësisë së jetës të komunitetit në këtë qark dhe reduktimi i kriminalitetit;

- Rritja e besimit të publikut tek policia e Shtetit;
- Forcimi i bashkëpunimit polici – komunitet në të gjithë qarkun e Elbasanit;
- Rritja e rezultateve të luftës kundër krimeve të rënda, krimit të organizuar dhe trafikeve të paligjshme në të gjithë qarkun.

Ndërsa si objektiva afatshkurtra mund të përmend:

- Implementimi i strukturës së re të DVP Elbasan dhe komisariteve të Policisë Elbasan, Librazhd, Peqin, Gramsh dhe Cërrik;
- Rritja e kapaciteteve profesionale të punonjësve të policisë nëpërmjet zhvillimit të trajnimeve të specializuara;
- Identifikimi i problemeve dhe shqetësimeve të komunitetit në drejtim të sigurisë dhe planifikimi i masave që duhen marrë për zgjidhjen e tyre;
- Mbatja në kontroll të vazhdueshëm të grupeve kriminale dhe dokumentimi ligjor i veprimtarisë së tyre kriminale;
- Ri-formatimi i rolit të oficerit të policimit në komunitet dhe patrullës së përgjithshme dhe vënia e tyre në efikasitet të plotë.
- Normalizimi i trafikut rrugor dhe reduktimi i aksidenteve me pasoja të rënda.

Pyetje: Cila është përshtypja juaj për Drejtorinë Vendore të Policisë Elbasan?

Përgjigje: Drejtoria Vendore e Policisë Elbasan është një nga drejtoritë kryesore, për shkak të pozicionit gjeografik të Qarkut që mbulon si dhe të problematikës që ballafaqohet me luftën kundër krimit.

D.V.P. Elbasan ka kapacitetet e duhura për realizimin e prioriteteve dhe objektivave të MB dhe DPP, si dhe për të përmirësuar performancën dhe rritur besimin e publikut.

Pyetje: A mund të na përshkruani me pak fjalë strukturën e re dhe ku do konsistojnë ndryshimet në Drejtorinë Vendore të Policisë Elbasan?

Përgjigje: Struktura e propozuar e DVP Elbasan, përbëhet nga:

- Drejtori i DVP.
- Zëvendësdrejtor Për Hetimin e Krimit
- Zëvendësdrejtor për Sigurinë dhe Policimin në Komunitet
- Sektori i Analizës, Planifikimit, Monitorimit dhe Vlerësimit.

- Sektori i Hetimit të Krimeve.
- Sektori i Rendit.
- Sektori i Shërbimeve të Specializuara.
- Sektori i Sigurisë Rrugore.
- Sektori i Komandimit dhe Koordinimit.
- Sektori i Financës
- Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Trajnimeve
- Sektori i Logjistikës/IT

Risi në këtë strukturë është krijimi i dy funksioneve zëvendësdyrektori, që lehtëson procesin e menaxhimit dhe drejtimit të shërbimeve policore. Gjithashtu në varësi të drejtpërdrejtë të drejtorit do të jetë dhe Sektori i Analizës, planifikimit, monitorimit dhe vlerësimit. Roli i këtij sektori është grumbullimi i informacionit dhe përgatitja e një analize, për identifikimin, vlerësimin dhe priorizimin e risqeve. Ky Sektor do të përgatisë propozime afatshkurtra për vendimmarrje, në propozimet strategjike dhe operacionale afatmesme dhe afatgjata. Përveç kësaj, do të monitorojë dhe vlerësojë proceset e punës dhe rezultatin e ndikimit të shërbimit të ofruar nga strukturat e DVP.

Ndërsa në Komisaratin e Policisë Elbasan, Shefi i Komisarariatit të Policisë do të mbështetet nga një Zëvendës Shef Komisarati, i cili do të ketë përgjegjësi dhe kompetenca të përcaktuara, si dhe të deleguara nga Shefi i Komisarariatit.

Në përbërje të seksionit të policimit në komunitet do të jenë edhe 2 punonjës policie të specializuar dhe me integritet, si dhe me aftësi shumë të mira komunikuese dhe me aftësi për mësimdhënie.

Këta punonjës policie do të përmbushin detyra në të gjithë territorin në juridiksion të komisarariatit të policisë që lidhen kryesisht për bashkëpunimin me institucionet arsimore për zhvillimin e temave mësimore për reduktimin e përdorimit të drogave, alkoolit, duhanit, njohjen me rregullat e qarkullimit rrugor, punën me të rinjtë për parandalimin e kryerjes së veprave penale nga grup moshat e reja, çështje të radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm, njohjen me problematikat që shqetësojnë komunitete në zona të veçanta apo edhe organet të qeverisjes vendore dhe institucionet e tjera shtetërore që lidhen me rendin dhe sigurinë.

Për të lehtësuar dhe krijuar mundësinë shërbimeve policore që të njohin situatën e rendit publik dhe të kriminalitetit, territori në juridiksion të Komisarariatit të Policisë Elbasan do të ndahet në 7 Zona Gjeografike që do të emërtohen "Zona Policore".

Pyetje: Cilat janë avantazhet dhe disavantazhet e implementimit të strukturës së re në Qarkun e Elbasanit?

Përgjigje: Struktura e re DVP Elbasan krijon këto avantazhe:

- Rritet roli dhe përgjegjësia e drejtuesve të DVP dhe komisariateve për planifikimin, analizimin dhe monitorimin e punës të të gjithë strukturave policore në përbërje të drejtorisë.
- Krijohet një raport i drejtë ndërmjet eporëve dhe vartësve në një sektor dhe seksion.
- Përqendrohen shërbimet e sigurisë publike nën drejtimin e një zëvendësdyrektori.
- Përqendrohen strukturat e hetimit të krimit nën drejtimin e një zëvendësdyrektori.
- Përqendrohen kapacitetet profesionale dhe teknike të policisë rrugore në një sektor, i cili do të bëjë të mundur që të përdoren më me efektivitet këto struktura.
- Reduktohet numri i personave në vartësi të drejtorit, zëvendësdyrektorit, shefave të sektorëve dhe në vartësi të shefave të seksioneve.
- Sigurohet një shpërndarje më funksionale e specialistëve të hetimit të krimit të organizuar në bazë drejtimi.
- Rritet efektiviteti dhe efikasiteti i ndihmës specialistëve për krimet duke i përqendruar në një seksion të veçantë, të cilët do të sigurojnë mbështetjen e të gjithë strukturave të drejtorisë vendore të policisë në përmbushjen e detyrave funksionale.
- Rritet efektiviteti dhe efikasiteti i njësive "Shqiponja", duke i përqendruar në një seksion të veçantë, të cilët do të sigurojnë mbështetjen e të gjithë strukturave policore në përmbushjen e detyrave funksionale.
- Rritet roli dhe përgjegjësia e shërbimit të sallës së komandimit, nisur nga fakti se ky shërbim në veçanti gjatë turnit të dytë dhe të tretë përmbush detyra që lidhen drejtpërdrejtë me menaxhimin e shërbimeve policore gjatë ndodhjes së ngjarjeve të ndryshme kriminale.

Pyetje: Kush janë efektet pozitive të strukturës së re mbi qytetarët?

Përgjigje: Kjo strukturë mundëson rritjen e bashkëpunimit me qytetarët, ndikon në rritjen e besimit të komunitetit tek policia, dhe rrit cilësinë e shërbimeve policore ndaj qytetarëve.

Pyetje: A mund të humbasë dikush vendin e punës me implementimin e strukturës së re dhe a parashikon riorganizimi shkurtime në personel apo shtesa?

Përgjigje: Implementimi i strukturës së re parashikon një rishpërndarje të burimeve njerëzore të drejtorisë dhe komisariateve të policisë së Elbasanit sipas situatës së kriminalitetit dhe nevojave të komunitetit. Kjo nuk do të ketë efekte në humbjen e vendeve të punës, pasi shkurtimi i disa funksioneve organike në një strukturë do të shoqërohet me shtimin e funksioneve tek strukturat e tjera sipas nevojave. Si rezultat numri i përgjithshëm i punonjësve të policisë nuk ndryshon.

Pyetje: Çfarë të rejash do të sjellë struktura e re në lidhje me bashkëpunimin me komunitetin dhe aktorë të tjerë?

Përgjigje: Në lidhje me bashkëpunimin me komunitetin dhe aktorët e tjerë kjo strukturë e re do të krijojë këto avantazhe:

- Mundëson krijimin e zonave policore, të cilat do të lehtësojnë ofrimin më të shpejtë të shërbimeve policore për komunitetin;
- Shërbimet e policisë me këtë ndarje punë do të jenë më pranë qytetarëve dhe kjo do të ndikojë jo vetëm në rritjen e bashkëpunimit, por edhe në parandalimin dhe reagimin më të shpejtë në rastet e ngjarjeve të ndryshme kriminale;
- Në çdo zonë policore, do të përmbushin detyra të njëjtët punonjës policie, në mënyrë të vazhdueshme. Kjo do të lehtësojë procesin e njohjes së situatës nga punonjësit e policisë, por dhe forcimin e lidhjeve me qytetarët.
- Si konkluzion struktura e re do të jetë më fleksible dhe do të ndikojë në rritjen e cilësisë së shërbimeve ndaj komunitetit.

Pyetje: Cili do të jetë roli i këshillave lokalë të sigurisë?

Përgjigje: Sikur se dihet, pranë Bashkisë Elbasan, me kontributin edhe të OSBE-së, është krijuar Këshilli Lokal i Sigurisë, nën drejtimin e Kryetarit të Bashkisë. Në përbërje të këtij Këshilli janë drejtuesit e organeve të zbatimit të ligjit në Elbasan, prokurori, gjykatë, polici, SHISH etj., drejtues të institucioneve shtetërore si Arsimi, Shëndetësia etj. si dhe OJF të ndryshme. Në takimet që zhvillon ky organ, do të diskutohen të gjithë problematikat që lidhen me sigurinë dhe mbi këtë bazë do të propozohen zgjidhje dhe do të merren detyra dhe përgjegjësi konkrete nga secili institucion për trajtimin e këtyre problemeve. Kjo është një risi pasi nxit përfshirjen e të gjithë institucioneve, përfaqësuesve të komunitetit dhe pushtetit vendor në adresimin e problemeve të sigurisë dhe marrjen e vendimeve më të pjekura në këtë drejtim.

Njoftim për Krijimin e Sektorit të Analizës Strategjike, Raportimit, Monitorimit dhe Vlerësimit.

Në kuadrin e ristrukturimit të D.V.P. Elbasan përveç tjerash, krijohet **sektori i ri, analizës strategjike i raportimit, monitorimit dhe vlerësimit.**

Ftohen punonjësit e DVP Elbasan të shprehin interesin e tyre për pozicionet e punës që do të krijohen brenda këtij sektori.

Grupi i punës ka punuar në përshkrimin e detyrave dhe kompetencave të sektorit dhe të përshkrimeve të punës të specialisteve në përbërje të tij. Në bazë të këtyre dokumenteve ky sektor parashikon në përbërje të tij punonjës të policisë me gradat Krye-Komisar, Komisar dhe Nën Komisar.

Detyra kryesore e këtij funksioni është:

- Mbledhja e të dhënave për sigurinë dhe rendin publik
- Analizimi i të dhënave të mbledhura dhe trendin dhe zhvillimin e riskut (analiza e riskut)
- Planifikimi i programeve, përpunimi i koncepteve dhe planeve të punës bazuar në analiza të dhënave
- Propozimi i zgjidhjeve tek vendimmarrësit për fushat strategjike, operacionale dhe taktike
- Raportimi (vjetor, mujor, javor dhe ditor me kërkesë ose me iniciativën e vet)
- Monitorimi i proceseve të punës në lidhje me detyrat e DVP-së dhe monitorimi strategjiv kombëtar dhe vendor dhe planet përkatëse të veprimit.
- Vlerësimi i rezultateve të DVP-ve në lidhje me sigurinë publike

Aftësitë profesionale :

- Njohuri mbi procedurat e analizës së informacionit
- Përpunimi i statistikave të sistemit të monitorimit dhe vlerësimit në policinë e shtetit.

Aftësitë vetjake:

- Të jetë i aftë të vlerësojë drejt situatat dhe të marrë vendime të arsyeshme;
- Të bashkëpunojë me të tjerët me besim dhe të jetë konstruktiv;
- Të pranojë mendimet e të tjerëve dhe të njohe punën në grup;
- Të punojë me efikasitet dhe të jete i orientuar drejt rezultatit;
- Të zbatojë urdhra në mënyrë të sakte;
- Të formulojë raporte dhe deklarime të sakta;

Në rast se kandidatët nuk plotësojnë kriteret e mësipërme, aplikantët e përzgjedhur do të trajtohen nga stafi i Programit SCPA në Akademinë e Sigurisë.

Masat e marra nga Drejtoria Vendore e Policisë Elbasan me rastin e Ditës së Verës.

Drejtoria Vendore e Policisë Elbasan ka marrë një sere masash për mbarëvajtjen e festes së 14-

Na kontaktoni në :

Tel :

+ 355 69 411 5061

Tel : + 355 69 4111626

E-mail :

dpq.elbasan@gmail.com

fb account: drejtoria vendore policisë elbasan

Marsit, Ditës së Verës, në të gjithë Qarkun e Elbasanit, për shkak të shtimit të numrit të automjeteve dhe rritjes së fluksit të lëvizjeve në akset kryesore dhe nëpër qendrat e banuara.

Gjatë festimit të Ditës së Verës në qytetin e Elbasanit, Drejtoria Vendore e Policisë Elbasan, ka marrë të gjitha masat, për organizmin e shërbimeve të Drejtorisë dhe Komisariateve të Policisë Elbasan, Cërrik, Librazhd, Gramsh, Peqin dhe të stacioneve Belsh dhe Përrenjas në mbarëvajtjen e aktiviteteve festive para gjatë dhe deri në përfundim të aktiviteteve festive që do të zhvillohen me rastin e Ditës së Verës.

1. Të gjitha shërbimet në Drejtorinë e Policisë Elbasan, më datë 13.03.2018 do të kalojnë në shërbim të përforcuar për zhvillimin sa më normal të aktiviteteve festive.
2. Për të përballuar me sukses festimin sa më normal të Ditës së Verës, në ndihmë të shërbimeve të Policisë Elbasan, do të vihen në dispozicion dhe forca nga FNSH Tiranë.
3. Do të merren të gjitha masat për parandalimin e ngjarjeve të mundshme kriminale gjatë zhvillimit të aktiviteteve.
4. Nga Policia Rrugore do të kontrollohen të gjitha akset me qëllim për të bërë të mundur qarkullimin normal të mjeteve gjatë zhvillimit të aktiviteteve.

Në këtë plan masash do të angazhohen 321 forca policie nga Elbasani dhe FNSH Tiranë.

Në kuadër të masave të marra për mbarëvajtjen e aktiviteteve me rastin e Ditës së Verës Specialistët e Sektorit të Qarkullimit Rrugor, në Drejtorinë Vendore të Policisë Elbasan, nuk do të lejojnë lëvizjen apo parkimin e mjeteve në këto akse rrugore:

1. Në orën 07:00 të datës 14.03.2018 deri në përfundim të aktivitetit të Karnavaleve do të bllokohet lëvizja në bulevardin "Aqif Pasha" nga Stadiumi deri tek 1 Maji dhe nuk do të lejohen parkimet e mjeteve nga "Rreth rrotullimi i Luleve - Bashkia"
2. Nga stadiumi deri tek "Pallati i Sportit", nuk do të lejohen parkimet apo qëndrimet e mjeteve.
3. Më datë 14.03.2018 mjetet e tonazhit të rëndë të evitohen lëvizjen në aksin rrugor Elbasan – Librazhd.

Policia Rrugore krahas masave të marra për mbarëvajtjen e trafikut, do të ketë dhe një sërë masash për shtimin e kontrollit ndaj përdoruesve të rrugës, që drejtojnë automjetin në gjendje të dehur, që tejkalojnë normat e shpejtësisë, që kryejnë parakalime të gabuara, etj Drejtoria Vendore e Policisë Elbasan, kërkon mirëkuptimin e pjesëmarrëseve në këtë ditë feste, të evitohen në maksimum lëvizjen me automjet brenda qytetit të Elbasanit, çka do të sillte një ndihmesë të madhe në zhvillimin sa më normal të aktiviteteve festive.

Duke falënderuar qytetarët për mirëkuptimin dhe mediat për bashkëpunimin, Drejtoria Vendore e Policisë Elbasan ju uron Gëzuar Ditën e Verës!



Ky Botim u pergatit
ne bashkepunim me
Programin SCPA

